



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 851/4 prot.,

Tiranë, më 09/03/2026

Lënda: Njoftim për vlerësimin e verifikimit paraprak të kandidatëve sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor”.

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 18, 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, u realizua verifikimi paraprak i kandidatëve që konkurrojnë për pozicionet vakante të shpallura në Gjykatën e Lartë me shpalljet e datës 15.02.2026, sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor” dhe kualifikimi i kandidatura që plotësonin kushtet e përgjithshme dhe kriteret e vecanta, për fazën e dytë

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatët u konstatua se për vakancën:

1(një) vend vakant, sekretare regjistruese – Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria ekzekutive IV-1,

kandidatët e kualifikuar për fazën pasardhëse të konkurrimit të hapur , të testimit me shkrim janë:

- Znj. Anxhela Brahimi
- Znj. Sandra Mali
- Znj. Suzana Lita
- Znj. Arjana Duraku
- Znj. Ergerta Beshi

Testimi me shkrim do të zhvillohet më datë **17.03.2026**, ora **11.00** . Kandidatët do të njoftohen edhe nëpërmjet postës elektronike të depozituar në dokumentacionin e dorëzuar.

KANCELAR NË DETYRË

ANILA KULO

